



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09 dhe 43/2014), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01 / 2015

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Kodi i masës	Emri i masës	Vlera maksimale mbështetjes financiare
1	Mbështetje teknike në bujqësi dhe zhvillim rural	
1.4	Ndihmë për marketing të prodhimeve bujqësore dhe prodhime të përpunuara bujqësore <ul style="list-style-type: none"> Vendosje dhe punë të vendeve të unifikuara dhe specializuara për shitje për shitje të verës me prejardhje nga Republika e Maqedonisë 	Deri në 1.500.000 denarë për rregullim të brendshëm Deri më 30.000 denarë në muaj për qira Deri më 2 paga mesatare në veprimtarinë për të punësuar
112	Ndihmë të bujqve të rinj për fillim të veprimitarisë bujqësore	Deri më 600.000 denarë shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual
122	Investime për rritje të vlerës ekonomike të pyjeve	
122.1	Ekonomizim të qëndrueshëm me pyjet	Deri më 20.000 denarë për shënim të dukshëm dhe të qëndrueshëm deri më 500 denarë për metër kub, por jo më shumë se 10.000 denarë për shërbime për ekonomizim me pyjet deri më 120.000 denarë për furnizim të pajisjeve

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë:

Subjektet	Kodi i masës
Subjekte juridike të regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare, Ligjin për hoteleri dhe të cilët do të plotësojnë kushtet në pajtim me Ligjin për tregti	Masa 1.4
Ekonomi bujqësore të regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (RVEB) në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural	Masa 112
Shfrytëzues potencial mund të jetë subjekti juridik ose fizik pronar i pyllit privat ose shoqata e pronarëve privat të pyjeve.	Masa 122

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet e dedikuara për investime në vendosjen dhe punën e vendeve të unifikuara dhe specializuara për shitje për shitje të verës me prejardhje nga Republika e Maqedonisë edhe atë në: Berovë, Kavadar, Strumicë, Prilep, Manastir dhe Krushevë nga një shitore.

Mbështetje financiare paguhet sipas parimit të bashkëfinancimit të investimeve të paguara dhe të përfunduara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej:

- 50% e shpenzimeve të bëra për pajisjen e shitores me përjashtim të investimeve për hapësira ndihmëse dhe sanitare, por jo më shumë se 1.500.000 denarë
- 50% e shumës së qirasë vjetore, por jo më shumë se 30.000 denarë në muaj.
- Më së shumti dy pagesa mesatare në veprimtari për dy persona të punësuar për shitje të verës në shitore

Për Masën 122, mbështetja financiare paguhet në parim të bashkëfinancimit të investimeve të mbaruara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investimet.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për Masën 112 është 600.000,00 denarë. Mjetet ndahen për periudhën e realizimit të planit afarist dhe paguhet në nivel vjetor në më së shumti tre këste. Mbështetja është e kushtëzuar me plotësim të detyrueshëm të aktiviteteve të parapara nga Plani afarist për masën 112

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masë të veçantë dorëzohen në origjinal.

Një kërkesë mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të dorëzojë më së shumti 2 kërkesa të veçanta për masa të ndryshme duke marrë parasysh masat e tjera nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015. Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të vërtetuara me:

- Programi për përkrahje financiare në zhvillimin rural për vitin 2014 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196/2014),
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013 dhe 106/2013),
- Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për përkrahje nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe lartësia e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për masa individuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011, 80/2013 dhe 72/2014),
- Rregulloren për kritere më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011 dhe 80/2013).
- Rregullore për llojin e aktiviteteve, shumës maksimale për aktivitete, shfrytëzuesit, subjektet të cilat marrin pjesë në procedurë, kriteret më të përafërta dhe mënyrën e ndarjes së mbështetjes teknike në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 06/2013, 81/2013, 181/2013, 01/2014, 23/2014 dhe 136/2014)

Kërkesit duhet të shtrojnë Kërkesë përkatëse për shfrytëzim të mjeteve për Masat 112, 122 dhe 1.4 dhe dokumentacionin e theksuar të nevojshëm,

Kërkesit të cilat i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masat 112 dhe 122 rangohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës.

Kërkesat me numër të njëjtë të pikave për masën 1.4 do të rangohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës.

Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.

Shfrytëzuesit e mjeteve duhet ti kenë të shlyera të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave si dhe obligimet financiare për vitin 2014 ndaj Ndërmarrjes publike për ekonomizim me kullota dhe obligim për ujë ndaj ndërmarrjeve për ujësjellës.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve" me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk si dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitë punuese të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në adresën e Agjencisë çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për pagim nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2015 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2015 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës. Afati përfundimtar i dorëzimit të kërkesave për mbështetje financiare është 31.03.2015.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve dhe Sektori lejim të pagesave.

Telefon 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej 08.30 deri në ora 16.30

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL